



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.350/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova, Bujar Muzaqi dhe anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të parashtruara kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë;09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;06.02.2025, merr këtë,

**V E N D I M**

I. Pranohet si e bazuar, ankesa e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.350/2025, e datës;04.02.2025.

II. Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5.000.00 € (Pesëmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datë 04.02.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.350/2025, të parashtruar nga Subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 03 shkurt 2025, kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Kryeministër i Republikës së Kosovës, në tubimin e mbajtur në Komunën e Gjilanit, në fjalimin e mbajtur në këtë tubim, ndër të tjerash deklaroi: ....Sikur partitë e tjera opozitare edhe prokuroria e shtetit që u bë si parti politike opozitare, ka me i humbë zgjedhjet me shkurt. Po a e dini çka pas 9 shkurtit ata nuk do të kenë as deputetë në Kuvend qysh mund t'i ketë naj parti opozitare, nëse ka fat me kalu pragun. E meqenëse partia më e re politike opozitare prokuroria e shtetit nuk do të ketë deputet në legjislaturën e 9-të, atëherë le të shkoj në shpi, me 10 shkurt s'ka pse del n'punë se s'janë tu bo punë, le të rrinë në shtëpi.... e jo më k'si prokurorsh që Milan Radojcicit ja hjekin urdhërarrestin, e ndjekin Rozeta Hajdarin". Më tej në ankesë theksohet se kjo gjuhë e përdorur përmban nxitje, urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherit shprehë ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese dhe mbi të gjitha linçuese ndaj organeve të drejtësisë, të cilat ushtrojnë pushtetit gjyqësor në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Provë: CD me përmbajtje të video incizimit të fjalimit

në tubimin e mbajtur nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gjilanit, në të cilën nga minuta 00:50 e deri në përfundim të video incizimit. Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, theksohet se deklarimet e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në tubimin elektorale në Gjilan, pra në një tubim garues elektorale, përveçse nuk përbëjnë ndonjë shkelje nga dispozitat përkatëse, konsiderojnë se të njëjtat janë në përputhje të plotë me legjislacionin dhe rregullativën zgjedhore si dhe me frymën e një fushate elektorale. Për më shumë, Kryeministri i referohet një gjendjeje jo të mirë në sistemin e drejtësisë, në kuptimin e efikasitetit të organeve përkatëse sa i përket ndjekjes penale dhe nevojës për përmirësimin e gjendjes së tillë në të ardhmen.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë, vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, përkatësisht, CD-së, gjen se kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje, z. Albin Kurti, aktualisht, Kryeministër i Republikës së Kosovës, në tubimin e mbajtur në Komunën e Gjilanit, ka deklaruar se *“Sikur partitë e tjera opozitare edhe prokuroria e shtetit që u bë si parti politike opozitare, ka me i humbë zgjedhjet me shkurt. Po a e dini çka pas 9 shkurtit ata nuk do të kenë as deputetë në Kuvend qysh mund t'i ketë naj parti opozitare, nëse ka fat me kalu pragun. E meqenëse partia më e re politike opozitare prokuroria e shtetit nuk do të ketë deputet në legjislaturën e 9-të, atëherë le të shkoj në shpi, me 10 shkurt s'ka pse del n'punë se s'janë tu bo punë, le të rrinë në shtëpi... e jo më k'si prokurorsh që Milan Radojcicit ja hjekin urdhërrrestin, e ndjekin Rozeta Hajdarin.”*

Sipas vlerësimit të Panelit, nga deklarimi i tillë i kandidatit për deputet, konsiderohet se është përdorë gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve, në kuadër të fushatës zgjedhore, dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes në raport me prokurorin e shtetit, përkatësisht, prokurorët. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe të përgjithësi atmosferë destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin përcaktohet se *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, është përcaktuar se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet *“të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.”*

Paneli, me rastin e vendosjes se dënimit me gjobë si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm i subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Prandaj Paneli vëren, se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së 34 LZP-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme, si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë, e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se subjekti politik LVV të njëjtat pretendime nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, lidhur me nenin 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.350/2025, datë;06.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.